



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 555, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË, TË DISA KLASAVE TË ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Dituri natyre”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës bërthamë, për klasën e pestë, klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit bazë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 17, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
18. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë (frënge, italiane, gjermane), për shkollat me marrëveshje me ambasadat", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 18, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
19. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 19, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

20. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 20, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
21. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 21, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
22. Programet mësimore të klasës së parë dhe klasës së gjashtë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
23. Programet mësimore të klasës së shtatë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
24. Programi mësimor i klasës së pestë hyn në fuqi dhe fillon zbatimin në vitin shkollor 2029 – 2030.
25. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.
26. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “DITURI NATYRE” ARSIMI FILLOR KLASA 1

FUSHA “SHKENCAT E NATYRËS”

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinatorë: Mirela Gurakuqi, Mimoza Milo, Elisabeta Paja



PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	5
2	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME.....	5
2.1	Objektivat e përgjithshme.....	5
3	Përmbajtja e programit.....	7
3.1	Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit	9
3.2	Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën	12
3.3	Kompetencat dhe rezultatet e të nxënit.....	14
4	Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit	19
4.1	Koha mësimore për secilën tematikë - Klasa e parë	19
4.2	Përmbajtja e programit - Klasa e parë	19
4.2.1	Tematika: Të menduarit dhe të vepruarit në mënyrë shkencore	20
4.2.2	Tematika: Forca dhe energjia	21
4.2.3	Tematika: Drita dhe tingujt.....	22
4.2.4	Tematika: Elektriciteti dhe magnetizmi	23
4.2.5	Tematika: Toka dhe hapësira.....	23
4.2.6	Tematika: Struktura dhe funksionimi i organizmave të gjallë	24
4.2.7	Tematika: Materialet.....	25

4.2.8	Tematika: Vetitë e materialeve.....	26
4.2.9	Tematika: Shkenca në praktikë	26
4.3	Qëndrime dhe vlera	27
5	Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve)	28
6	Metodologjia e mësimdhënies	35
6.1	Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale	37
6.2	Roli i projekteve kurrikulare	38
6.3	Puna me nxënësit me nevoja të veçanta	40
6.4	Puna me nxënësit e talentuar.....	40
7	Vlerësimi i nxënësve.....	41
7.1	Llojet e vlerësimit.....	41
7.2	Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit.....	42
7.3	Shembuj të niveleve të arritjes (RN-ve)	43
8	Burimet dhe materialet didaktike	45
8.1	Përdorimi i teknologjisë dhe qasjes STEM.....	45
9	Rekomandime për zbatimin e programit	47
a)	<i>Rekomandime për mësuesit</i>	<i>47</i>

<i>b) Rekomandime për autorët e teksteve shkollore.....</i>	<i>48</i>
<i>c) Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare.....</i>	<i>48</i>
<i>d) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm</i>	<i>48</i>
<i>e) Rekomandime për prindërit</i>	<i>49</i>
<i>f) Rekomandime për nxënësit</i>	<i>49</i>
10 Ndryshimet përmbajtësore	50
 Tabela 1 . Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.....	10
Tabela 2 . Kompetencat shkencore dhe rezultatet e të nxënit	17
Tabela 5 . Shembuj veprimtarish për përmbushjen e RN	28
Tabela 6 . Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN	43
 Diagrama 1 . Përmbajtja e programit	7
Diagrama 2 . Korniza konceptuale.....	16
Diagrama 3 . Shembull situatë të nxëni dhe lidhja me elementet e programit	38

1 HYRJE

Shkencat e natyrës në arsimin fillor kanë si qëllim të zhvillojnë te nxënësit kureshtjen dhe të ndërtojnë bazat e të kuptuarit shkencor për botën që i rrethon. Programi ofron mundësi për të njohur dhe kuptuar koncepte dhe fenomene shkencore nga disiplina të ndryshme, si: fizika, kimia, biologjia, shkenca e tokës dhe hapësirës. Secila lëndë kontribuon në zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe analitik, duke nxitur nxënësit të vëzhgojnë, të eksperimentojnë, të mbledhin të dhëna dhe të nxjerrin përfundime në lidhje me dukuritë natyrore që ndodhin në botën përreth tyre. Nëpërmjet lëndës Dituri Natyre, nxënësit zhvillojnë kompetenca që i ndihmojnë të kuptojnë ndërveprimet e proceseve natyrore, si dhe përvetësojnë teknikat e kërkimit shkencor. Kjo është e lidhur ngushtë me qasjen STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematika), e cila ndihmon nxënësit të shohin lidhjet ndërmjet shkencës dhe teknologjisë, duke i përgatitur ata për sfidat e shekullit XXI. Gjithashtu, i mundëson atyre të kontribuojnë aktivisht në zhvillimin e shoqërisë dhe të përballojnë problemet që lidhen me mjedisin, shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Shkencat e natyrës u japin nxënësve njohuri të thella për botën që i rrethon, ndërtojnë baza të forta shkencore dhe zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të kuptuar e zgjidhur probleme reale. Kjo përgatitje i aftëson ata të kontribuojnë në mënyrë të përgjegjshme dhe novatore në një shoqëri ku teknologjia përparon me ritme të shpejta.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Programi është hartuar për të mbështetur mësimdhënien efektive të shkencës gjatë gjithë ciklit fillor. Ky program nxit zhvillimin e njohurive dhe aftësive që u mundësojnë nxënësve të përshkruajnë, shpjegojnë dhe hetojnë botën përreth tyre në një nivel të përshtatshëm për moshën.

Nxënësit zhvillojnë një qasje holistike ndaj shkencës, duke kombinuar faktet shkencore, aftësitë praktike, njohuritë dhe të kuptuarit, të cilat nevojiten për të shpjeguar dukuritë natyrore.

2.1 Objektivat e përgjithshme


Programi synon të:

- ✓ Zhvillojë kureshtjen për botën dhe interesin për shkencën;

- ✓ Zhvillojë të kuptuarit e koncepteve bazë shkencore;
- ✓ Zhvillojë aftësitë shkencore në mënyrë që të bëhet gjithnjë e më i pavarur kur vë në pikëpyetje dhe hulumton dukuritë;
- ✓ kuptojë se modelet shkencore përdoren për të shpjeguar dukuritë;
- ✓ Lidhë shkencën me kontekstet e botës reale në aspektin personal, kombëtar dhe global, duke identifikuar rëndësinë e shkencës për botën moderne.
- ✓ Të lidhë njohuritë shkencore me fusha të tjera të dijes, veçanërisht me shkencat, teknologjinë dhe inxhinierinë, duke përdorur qasjen STEM;
- ✓ Të punojë në mënyrë bashkëpunuese dhe efektive në zgjidhjen e problemeve shkencore përmes projekteve, detyrave në grup dhe debateve të strukturuar;
- ✓ Të zhvillojë vetëbesimin, këmbënguljen dhe qëndrimin pozitiv ndaj sfidave shkencore dhe të kuptojë rëndësinë e të menduarit shkencor në jetën e përditshme dhe për një të ardhme profesionale;
- ✓ Të kuptojë dhe të përdorë mënyra etike dhe të përgjegjshme në zbatimin e shkencës dhe teknologjisë gjatë zgjidhjes së detyrave shkencore.

3 Përmbajtja e programit

Diagrama 1. Përmbajtja e programit të lëndës



Programi synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës, si dhe të kompetencave kyçe, duke përdorur shembuj të situatave nga jeta reale. Në thelb, ky program përqendrohet në formimin e nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, interpretuar dhe zbatuar njohuritë shkencore në mënyrë funksionale e të ndërgjegjshme në jetën në e përditshme. Programi i lëndës Dituri Natyre në arsimin fillor përmban:

Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënësve që zhvillohen nëpërmjet lëndës Dituri Natyre. Kjo lëndë ndihmon në zhvillimin e kompetencave kyçe të nxënësve, si aftësitë për të menduarin kritik dhe për të zgjidhur probleme në situata reale.

Promovon zhvillimin e aftësive sociale, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe komunikimin efektiv mes nxënësve. Pjesëmarrja në eksperimente dhe aktivitete praktike ndihmon në zhvillimin e aftësive digjitale përmes përdorimit të teknologjisë në kërkimin shkencor.

Nxënësit zhvillojnë aftësitë për të analizuar dhe interpretuar të dhënat shkencore, duke përdorur metoda të hulumtimit dhe të vëzhgimit. Përmes lëndës, nxënësit forcojnë gjithashtu aftësitë për të marrë vendime të informuara dhe për të vepruar me përgjegjësi në jetën e përditshme.

Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës Dituri Natyre. Programi i dituri së natyrës integron temat ndërkurrikulare, që i ndihmojnë nxënësit të lidhin njohuritë shkencore me aspekte të jetës reale dhe me çështje të rëndësishme për shoqërinë. Kjo lëndë kontribuon në zhvillimin e identitetit kombëtar dhe njohjes së kulturave, duke përfshirë tematikat mbi biodiversitetin dhe pasuritë natyrore të vendit. Përmes përmbajtjes shkencore, nxënësit zhvillojnë njohuri mbi qytetarinë aktive dhe sipërmarrjen, duke kuptuar lidhjen ndërmjet shkencës dhe zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Disa nga temat e tjera të rëndësishme janë zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore, ku nxënësit mësojnë

si të mbrojnë mjedisin dhe të përdorin burimet natyrore në mënyrë të përgjegjshme. Për më tepër, lënda ndihmon nxënësit të kuptojnë ndikimin e teknologjisë dhe medias në shoqëri, duke integruar përdorimin e mjeteve digjitale dhe burimeve të informacionit shkencor për të zgjidhur probleme mjedisore dhe sociale.

Kompetencat dhe rezultatet e të nxënit. Programi synon të zhvillojë kompetenca që shkojnë përtej njohjes së koncepteve shkencore, duke u mundësuar nxënësve të përdorin mendimin kritik dhe logjik për të kuptuar dhe zgjidhur probleme të jetës reale. Kompetencat e zhvilluara përfshijnë aftësinë për të analizuar situata shkencore dhe për të nxjerrë përfundime të bazuara në të dhëna dhe vëzhgime. Nxënësit zhvillojnë aftësi për të formuluar dhe vërtetuar hipoteza, për të argumentuar mendimet e tyre në mënyrë të strukturuar dhe për të komunikuar rezultatet e kërkimeve të tyre në mënyrë të qartë dhe efektive.

Një tjetër kompetencë kyçe është aftësia për të përdorur teknologjinë dhe mjete digjitale për të zbatuar proceset shkencore, si mbledhja dhe analiza e të dhënave, përdorimi i simulimeve dhe modelimit digjital për të testuar hipoteza, si dhe për të zhvilluar aftësitë e menduarit kompjuterik. Këto kompetenca ndihmojnë nxënësit të bëhen kërkues të pavarur dhe të aftë të përdorin teknologjinë për të trajtuar probleme shkencore dhe për të analizuar dukuri natyrore. Si rezultat, ata janë më të përgatitur për të marrë vendime të informuara dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme.

 *Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit.* Në këtë rubrikë përshkruhet koha e dedikuar (numri i orëve mësimore) në varësi të klasës dhe kompleksitetit të tematikave, duke ofruar hapësirë për punë individuale, në grup dhe për projekte; tematikat e lëndës dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre; njohuritë kryesore, aftësitë për secilën tematikë dhe qëndrimet që demonstرون nxënësi.

 *Metodologjia e mësimdhënies.* Me rëndësi është t'i kushtohet vëmendje e madhe përdorimit të metodave interaktive, teknikave të të menduarit kritik, zgjidhjes problemore dhe bashkëpunimit. Puna me projekte të integruara dhe detyra problemore janë në fokus të zhvillimit të lëndës. Përshtatja e mësimi për nxënës me nevoja të veçanta dhe mbështetja e talenteve nxit kuriozitetin për lëndën. Në këtë rubrikë ka shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

 *Vlerësimi i nxënësve* është një tjetër rubrikë që përmbledh: llojet e vlerësimit të nxënësit, shembuj të instrumenteve të vlerësimit dhe vlerësimin si metodologji të nxëni. Gjithashtu në këtë rubrikë ka shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënit.

 *Burimet dhe materialet didaktike* që mund të përdoren. Zbatimi i teknologjisë dhe burimeve digjitale si mjete ndihmëse, do të trajtohet gjithashtu në program si burime të rëndësishme për zhvillimin e njohurive dhe aftësive.

 *Rekomandime për zbatimin e programit.* Kjo rubrikë ofron rekomandime për përdoruesit e programit lëndor siç janë: nxënësit, mësuesit, autorët e teksteve mësimore, hartuesit e testeve kombëtare, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë dhe prindërit.

 *Ndryshimet përmbajtësore.* Në këtë rubrikë do të përshkruhen përditësimet kryesore në përmbajtjen e lëndës.

3.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon nga mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale ndërmjet kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës, sipas klasave të arsimit fillor. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive.

Kompetenca kuptohet sot si një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundëson nxënësin të përballë me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja e mësimdhënies e bazuar në kompetenca zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit) drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke e vendosur vetë nxënësin në qendër të procesit.

Kompetencat e fushës së shkencave lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me kompetencat kyçe dhe me tematikat e lëndëve të fushës, të cilat janë në funksion të zhvillimit të tyre. Kompetencat e fushës së shkencave natyrore lidhen me kompetencat kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënit të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës dhe kompetencave kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet lidhja e rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe. Megjithatë paraqiten të ndara në tabelë, nuk ka një kufi të prerë të lidhjes së rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe, pasi një kufi i tillë nuk ekziston mes kompetencave në vetvete, si tek ato kyçe ashtu edhe tek ato të

fushës.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe që mund të zhvillojë nxënësi në lëndën e Diturisë së Natyrës mund të përmbledhen si më poshtë:

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> ▪ komunikon në mënyrë efektive si dëgjues, folës, lexues dhe shkruar; ▪ përshtat komunikimin me situatat dhe qëllimet; ▪ kërkon, mbledh dhe përpunon informacione me mjete ndihmëse; ▪ formulon dhe shpreh argumente në gojë dhe shkrim; ▪ merr pjesë në biseda për tema mësimore dhe shoqërore; ▪ prezanton projekte dhe tema përmes komunikimit verbal dhe elektronik; ▪ përshkruan ngjarje duke ruajtur rrjedhën logjike; ▪ analizon dhe përdor nocione të reja në kontekste të ndryshme.	<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> ▪ fillon, ndjek dhe përfundon biseda të thjeshta për tema të ndryshme; ▪ përdor mjetet dhe angazhohet në komunikim joformal; ▪ merr pjesë në biseda të thjeshta, duke bërë pyetje dhe dhënë përgjigje; ▪ transmeton saktë informacion në formë të ndryshme; ▪ prezanton një projekt të thjeshtë duke përdorur komunikimin verbal dhe elektronik; ▪ përshkruan ngjarje duke ruajtur rrjedhën logjike dhe duke përdorur lidhëza të thjeshta; ▪ diskuton për një temë duke respektuar rregullat e komunikimit; ▪ luan rol mbështetës në diskutime dhe ndihmon për të kontribuar.
Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri	Kompetenca digjitale
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> ▪ ndjek dhe vlerëson organizimin logjik të argumenteve; ▪ përdor mjetet dhe pajisjet teknologjike;	<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> ▪ përdor dhe përpunon përmbajtje digjitale;

▪ përdor të dhëna shkencore për të nxjerrë përfundime bazuar në prova; ▪ njeh karakteristikat e kërkimit shkencor dhe komunikon përfundimet; ▪ parashtron pyetje dhe organizon mendimet për zgjidhjen e problemeve; ▪ prezanton idetë për zhvillimin e aktiviteteve dhe argumenton ato; ▪ shfrytëzon teknika të ndryshme gjatë të nxënës dhe klasifikon informacionin; ▪ paraqet argumente për problemet nga matematika dhe shkencat; ▪ përdor informacionin për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve duke argumentuar; ▪ interpreton rregulla dhe procese me shembuj nga jeta e përditshme.	▪ analizon të dhënat për të nxjerrë përfundime dhe marrë vendime të informuara; ▪ identifikon dhe zgjidh probleme duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale; ▪ bashkëpunon me moshatarët duke përdorur teknologjinë për zgjidhjen e problemeve; ▪ përdor mendimin kritik për të planifikuar projekte.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënës	Kompetenca qytetare
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> ▪ identifikon dhe përmirëson përparësitë dhe dobësitë personale; ▪ organizon dhe fokusohet në të nxënës, vendos qëllime dhe vlerëson punën e tij; ▪ motivon dhe vlerëson veten, punon në mënyrë të pavarur dhe në grup;	<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> ▪ tregon solidaritet në zgjidhjen e problemeve në shkollë, komunitet e më gjerë; ▪ vlerëson diversitetin me tolerancë dhe respekt; ▪ demonstroi sjellje etike ndaj mjedisit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë mjedisore;

▪ shpreh dëshirë për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe bashkëpunon në mënyrë konstruktive; ▪ vlerëson jetesën e shëndetshme dhe praktikon zakone të shëndetshme ushqimore dhe fizike..	▪ reagon ndaj shkeljeve të të drejtave të të tjerëve dhe diskuton pasojat e këtyre veprimeve.
Kompetenca e sipërmarrjes	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> ▪ përdor imagjinatën për procese krijuese dhe novatore; ▪ planifikon projekte dhe i organizon; ▪ punon në mënyrë të pavarur dhe bashkëpunon; ▪ vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit; ▪ analizon pasojat e dëmtimit të mjedisit dhe organizon aktivitete për mbrojtjen e tij; ▪ përdor materiale dhe teknologjinë për avancim në mësim dhe orientim në karrierë.	<i>Për të dëshmuar këtë kompetencë, nxënësi:</i> ▪ shpreh dhe interpreton emocionet dhe idetë e tij me art dhe forma të tjera kulturore; ▪ identifikon mundësi për të shprehur vlera personale, sociale nëpërmjet arteve; ▪ angazhohet në procese krijuese, si individualisht ashtu dhe kolektivisht.

3.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën

Integrimi i temave ndërkurrikulare u mundëson nxënësve të kuptojnë lidhjet ndërmjet lëndës Dituri Natyre dhe jetës reale, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi analitike, mendim kritik, argumentim dhe zgjidhje problemesh. Këto tema përforcojnë përdorimin e shkencës si mjet për interpretimin e të dhënave, planifikimin, marrjen e vendimeve dhe vlerësimin e situatave të ndryshme shoqërore, kulturore dhe shkencore.

- *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.* Në lëndën Dituri Natyre, identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave zhvillohen përmes kuptimit të pasurive natyrore dhe mjedisit që i rrethon nxënësit. Kjo lëndë ndihmon nxënësit të kuptojnë dhe vlerësojnë burimet natyrore të vendit të tyre, si dhe të ndërgjegjësohen për rëndësinë e ruajtjes së tij së mjedisit për brezat e ardhshëm. Duke mësuar për biodiversitetin, ekosistemet dhe pasuritë natyrore, nxënësit lidhin njohuritë shkencore me kulturën dhe traditat e vendit, duke vlerësuar lidhjen e thellë mes njeriut dhe natyrës. Përmes diskutimeve mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe pasurive natyrore, ata krijojnë një ndjenjë të fortë identiteti kombëtar dhe përgjegjësie për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Kjo gjithashtu ndihmon në formimin e një qytetari aktive dhe të përgjegjshme, që vlerëson dhe promovon diversitetin kulturor dhe natyror.
- *Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.* Në lëndën Dituri Natyre, qytetaria aktive dhe sipërmarrja janë të lidhura me mësimet shkencore dhe ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për jetën e tyre. Nxënësit angazhohen në projekte si fushata bamirësie, aktivitete ekologjike dhe panairë të vogla, ku përdorin njohuritë shkencore për të kuptuar dhe zgjidhur problemet që ndikojnë në mjedisin dhe shoqërinë. Ata mësojnë se si të menaxhojnë burimet, si natyrore ashtu edhe ato financiare, duke përdorur përqindje dhe statistika për të marrë vendime të drejta. Gjatë këtyre aktiviteteve, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të llogaritur kostot dhe fitimet, si dhe për të planifikuar projekte që ndihmojnë komunitetin. Kjo temë i ndihmon ata të kuptojnë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe t'i japin kontributin e tyre në zgjidhjen e problemeve që ndodhin përreth. Përmes këtij procesi, ata mësojnë të respektojnë përgjegjësitë dhe të zhvillojnë një qëndrim sipërmarrës dhe të përgjegjshëm në jetën e përditshme.
- *Shëndeti mendor, fizik dhe siguria.* Në lëndën Dituri Natyre, shëndeti mendor, fizik dhe siguria lidhen ngushtë me njohuritë shkencore që nxënësit mësojnë për trupin e njeriut dhe mjedisin që i rrethon. Nxënësit përdorin shënime dhe vëzhgime për të analizuar faktorë që ndikojnë në shëndetin e tyre, si aktiviteti fizik, ushqimi i shëndetshëm dhe higjiena. Përmes analizës së statistikave dhe të dhënave të shëndetit, ata mësojnë të vlerësojnë ndikimin e ushqimit dhe aktivitetit fizik në mirëqenien e trupit. Ata gjithashtu mund të përdorin edhe konceptet matematikore për të përllogaritur kaloritë që konsumojnë, për të ndjekur ndryshimet në parametrat truporë dhe për të kuptuar rreziqet që mund të shfaqen për shëndetin, duke përfshirë aspekte si pesha dhe niveli i aktivitetit fizik. Kjo i ndihmon ata të bëjnë zgjedhje të informuara për shëndetin e tyre dhe të kuptojnë rëndësinë e mbajtjes së një jete të shëndetshme dhe të balancuar.

- *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.* Në lëndën Dituri Natyre, zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore janë tema të rëndësishme që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë ndikimin e veprimeve të tyre me mjedisin. Ata mësojnë për burimet natyrore, energjinë, ujin dhe mbetjet, duke analizuar mënyrat për të ruajtur këto resurse dhe për të minimizuar ndotjen. Përmes këtyre analizave, ata kuptojnë si veprimtaritë e tyre të përditshme mund të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e një jete më të qëndrueshme. Lënda i nxit nxënësit të mendojnë për mënyra të thjeshta për të ruajtur mjedisin dhe për të kontribuar në një të ardhme më të qëndrueshme dhe të shëndetshme për të gjithë.
- *Teknologjia, shoqëria dhe media.* Në fushën e shkencave të natyrës, teknologjia, shoqëria dhe media ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e analizës dhe interpretimit të informacionit digjital. Ata mësojnë si të përdorin teknologjinë për të mbledhur dhe përpunuar të dhëna nga burime të ndryshme si rrjetet sociale dhe platformat digjitale. Nxënësit analizojnë ndikimin e medias dhe mësimin kritik për të kuptuar manipulimin e të dhënave dhe për të vlerësuar informacionin që ata marrin. Kjo u ndihmon nxënësve të krijojnë një kuptim të thellë për mënyrën se si teknologjia dhe media ndikojnë në jetën e përditshme dhe t'i përdorin ato në mënyrë të përgjegjshme dhe të informuar.

Shënim: Veprimtaritë praktike për zhvillimin e temave ndërkurrikulare përshkruhen më konkretisht në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

3.3 Kompetencat dhe rezultatet e të nxënit

I gjithë procesi i të nxënit në fushën e shkencave, në të gjitha ciklet, ka në fokus zhvillimin e **kërkimit shkencor**. Ai organizohet rreth tri kompetencave të kërkimit shkencor, në të gjitha ciklet e shkollimit. Kompetencat e fushës së shkencave natyrore lidhen me kompetencat kyçe edhe me njëra-tjetrën. Nëse kompetenca e parë, “Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre”, ka të bëjë me mënyrat e të arsyetuarit që i mundësojnë nxënësit të merret me probleme shkencore, dy kompetencat e tjera, “Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore” dhe “Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës”, e mësojnë atë se si të përdorë instrumentet dhe procedurat e duhura, si dhe si të komunikojë në gjuhën e shkencës dhe teknologjisë për të zgjidhur problemet. Duke zbatuar mënyrat e të arsyetuarit shkencor, nxënësi do të kuptojë natyrën e mjeteve, objekteve dhe procedurave të përdorura në këtë fushë, dhe do të jetë i aftë të vlerësojë ndikimin pozitiv apo negativ

të shkencës dhe teknologjisë në mjedis dhe shoqëri. Përveç kësaj, në prezantimin e shpjegimeve ose sqarimin e zgjidhjeve të veta, nxënësi ndërgjegjësohet për rëndësinë e përdorimit të saktë të gjuhës dhe terminologjisë në shkencë dhe teknologji.

Kompetencat arrihen nëpërmjet 3 tri linjave kryesore. Linjat mbështesin nxënësit në kuptimin dhe hetimin e dukurive natyrore, duke ofruar një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e aftësive, njohurive dhe qëndrimeve shkencore:

1. Linja e aftësive – Të menduarit dhe të punuarit në mënyrë shkencore
2. Linja e përmbajtjes – Biologjia, Kimia, Fizika, Toka dhe Hapësira
3. Linja kontekstuale – Shkenca në praktikë





Diagrama 2. Korniza konceptuale



Më poshtë paraqiten kompetencat shkencore dhe rezultatet përkatëse të të nxënit.

Tabela 2: Kompetencat shkencore dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat shkencore	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit për kompetencat shkencore <i>Klasa e parë</i>
Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre	Nxënësit zhvillojnë këtë kompetencë duke eksploruar aspekte të ndryshme të mjedisit, duke studiuar natyrën me strategji të përshtatshme, duke mbledhur informacione relevante dhe duke i analizuar ato me synimin për të ofruar shpjegime logjike ose zgjidhje praktike për problemet. Ata mund të fillojnë ta zhvillojnë këtë kompetencë në një moshë të hershme, por do të vazhdojnë ta bëjnë këtë gjatë gjithë shkollimit të tyre.	Nxënësi: - identifikon një problem ose përcakton një grup problemesh; - përdor strategji të ndryshme eksplorimi; - vlerëson qasjen e vet dhe të të tjerëve.
Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore	Kjo kompetencë na jep mundësinë të krijojmë përfaqësime të prekshme të botës ose të thellojmë kuptimin tonë për të. Ajo na fuqizon gjithashtu të analizojmë përdorimet e shkencës dhe teknologjisë në shoqërori dhe të marrim pjesë në mënyrë të informuar në vendimet që do të modelojnë shoqërinë e sotme dhe të ardhmen. Kjo aftësi shfaqet në detyra praktike si vizatimi i planeve, ndërtimi i prototipeve, matja e madhësive fizike dhe vëzhgimi i objekteve mikroskopike ose astronomike. Gjithashtu, ajo përfshin aftësinë për të kuptuar aplikimet e ndryshme të mjeteve dhe procedurave shkencore dhe teknologjike në situata	Nxënësi: - familjarizohet me rolet dhe funksionet e mjeteve, teknikave, instrumenteve dhe procedurave shkencore dhe teknologjike; - përdor mjete, objekte dhe procedura të ndryshme në përputhje me situatat dhe mënyrat e përdorimit të tyre në to; - vlerëson ndikimin e mjeteve, instrumenteve dhe procedurave.

	të ndryshme dhe për të vlerësuar efektet e tyre pozitive dhe negative, veçanërisht në jetën e përditshme.	
Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës	Kjo kompetencë i referohet aftësisë për të kuptuar dhe transmetuar mesazhe duke përdorur elementet e ndryshme të gjuhëve të posaçme të shkencës dhe teknologjisë. Nxënësit fillojnë duke përdorur prezantime të thjeshta si vizatime dhe diagrame, dhe gradualisht fitojnë aftësi në përdorimin e grafikëve dhe simboleve më komplekse. Gjatë gjithë edukimit të tyre, ata bëhen gjithnjë e më të aftë në përdorimin e gjuhëve dhe formave të përfaqësimit që përdoren në botën e shkencës dhe teknologjisë. Kjo i ndihmon ata të organizojnë dhe të shprehin mendimet e tyre në mënyrë më të strukturuar dhe të qartë.	Nxënësi: ▪ familjarizohet me gjuhën e jetës së përditshme që lidhet me shkencën dhe teknologjinë; ▪ përdor gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për shkencën dhe teknologjinë; ▪ përdor efektivisht gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për të formuluar pyetje dhe për të argumentuar përgjigjet.

4 Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit

4.1 Koha mësimore për secilën tematikë - Klasa e parë

Programi i lëndës Dituri Natyre për klasën e parë zhvillohet përgjatë 35 javëve mësimore, me nga 1 orë në javë (45 minuta), pra gjithsej 35 orë vjetore. Shuma e orëve për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor të arsimit bazë. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë peshën që zë secila tematikë në raport me orët mësimore totale. Në programin e Diturisë së Natyrës, afërsisht 40 % e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja, ndërsa 60 % e tyre për përpunimin e njohurive.

Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

Tematikat	Materialet dhe strukturat e tyre	Vetitë e materialeve	Struktura dhe funksionimi i organizmave të gjallë	Forcat dhe energjia	Drita dhe tingujt	Elektriciteti dhe magnetizmi	Toka dhe hapësira	Totali i orëve
Klasa I	3	3	10	6	5	4	4	35

4.2 Përmbajtja e programit - Klasa e parë

Në programin e lëndës **Dituri Natyre** për klasën e parë janë përfshirë tematikat përmbajtësore: *Forcat dhe energjia, Drita dhe tingujt, Elektriciteti dhe magnetizmi, Toka si planet, Materialet dhe strukturat e tyre, Vetitë e materialeve si dhe Struktura dhe funksionimi i organizmave të gjallë.*

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, aftësi, qëndrime e vlera. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë, që duhet të demonstrojë nxënësi, lidhur me tematikat përkatëse, ndërkohë qëndrimet dhe vlerat që demonstroi nxënësi në lëndë e diturisë natyrës përmbledhen për të gjitha tematikat.

Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkupton se përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Kombinimi i koncepteve dhe aftësive shkencore në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e

tyre, i lihet në dorë përdoruesve të programit (mësuesve dhe autorëve të teksteve) Në “përkthimin” e programit në tekste mësimore, temat dhe orët përkatëse shpërndahen në mënyrë logjike, sipas rrjedhës didaktike. Totali i orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese, ndërsa përdoruesit e programit kanë të drejtë të **shtojnë ose pakësojnë deri në 10%** të orëve të përcaktuara, për atë kohë sa respektohet numri i orëve vjetore të lëndës.

4.2.1 Tematika: Të menduarit dhe të vepruarit në mënyrë shkencore

Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë synon të zhvillojë te nxënësi kureshtjen e natyrshme dhe aftësinë për të bërë pyetje rreth botës që e rrethon. Ai bën parashikime për atë që mund të ndodhë dhe planifikon mënyrën si do ta zbulojë përgjigjen. Gjatë procesit të hulumtimit, ai mbledh dhe grupon materiale sipas ngjashmërive dhe dallimeve, duke përdorur pajisjet në mënyrë të sigurt dhe të saktë. Vëzhgimet dhe rezultatet i regjistron në tabela dhe përmes komenteve në imazhe. Në fund, nxënësi analizon të dhënat, i krahason me parashikimet dhe nxjerr përfundime që tregojnë nëse hipoteza e tij ishte e saktë apo jo. Kjo mënyrë pune zhvillon të menduarit kritik dhe logjik.

Hulumtimi shkencor: Qëllimi dhe planifikimi

- bën pyetje rreth botës që na rrethon dhe tregon për mënyrat si mund të gjejmë përgjigje;
- bën parashikime për atë që mendon se do të ndodhë.

Kryerja e hulumtimit shkencor

- mbledh dhe grupon trupa me materiale të ndryshme, duke u bazuar në ngjashmëritë dhe ndryshimeve midis tyre;
- përdor pajisjet e dhëna në mënyrë të duhur;
- ndjek udhëzimet në mënyrë të sigurt gjatë kryerjes së një punë praktike;
- mbledh dhe regjistron të dhëna nga vëzhgimet/ose matjet, duke bërë komente në imazhe dhe duke plotësuar tabela të thjeshta.

Hulumtimi shkencor: analiza, vlerësimi dhe konkluzionet

- përshkruan me detaje procesin e hulumtimit dhe tregon nëse të dhënat përputhen me parashikimet.

4.2.2 Tematika: Forcat dhe energjia

Forca dhe energjia	
Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë që lidhet me lëvizjen e trupave përqendrohet në mënyrën se si trupat në mjedisin përreth nesh lëvizin, ndalojnë apo ndryshojnë drejtim si rezultat i forcave që veprojnë mbi ta. Forca, e cila mund të jetë shtytje ose tërheqje, është veprimi që bën të mundur fillimin, ndalimin ose ndryshimin e lëvizjes së një trupi. Kjo forcë mund të veprojë , si për shembull kur shtyjme një karrige apo tërheqim një karrocë në sajë të energjisë që ne disponojmë. Objektet që na rrethojnë ndryshojnë lëvizje në varësi të madhësisë së forcës dhe drejtimit të saj. Kështu, duke vëzhguar trupat në mjedisin tonë, kuptojmë më mirë se si forca dhe energjia ndikojnë në lëvizjen e tyre çdo ditë.	
Njohuritë	Aftësitë
Shtytja dhe tërheqja - Lëvizja e trupave - Shtytja dhe tërheqja - Ndryshimet në lëvizje	Shtytja dhe tërheqja Nxënësi: <u>vrojton</u> mënyrat e ndryshme të lëvizjes së trupave në mjedisin përreth (p.sh.: lëkundet, vrapon, kërcen, rrotullohet, përshpejtohet, ngadalësohet, ndalon, noton, fundoset); <u>vrojton dhe provon</u> se për shkak të shtytjes dhe tërheqjes, trupi: a) mund të fillojë lëvizjen e tij; b) mund të përshpejtojë ose ngadalësojë lëvizjen e tij; c) mund të ndryshojë mënyrën/drejtimin e lëvizjes së tij; d) mund të ndalojë lëvizjen e tij. <u>tregon</u> pse lëvizin trupat në mjedisin përreth; <u>regjistron</u> mënyrën e lëvizjes së trupave; <u>krahason</u> mënyrën e lëvizjes së trupave.

4.2.3 Tematika: Drita dhe tingujt

Drita dhe tingujt

Përshkrimi i tematikës: Drita dhe tingujt janë dy forma të ndryshme të energjisë që perceptohen nga njeriu në mënyra të ndryshme. Burimet e tingullit janë ato objekte që lëshojnë valë akustike, si p.sh. tingujt e krijuar nga një instrument muzikor ose një zhurmë e përditshme. Përhapja e tingullit ndodh përmes ajrit, ujit ose materiale të tjera, duke u zhvendosur nga burimi nëpërmjet valëve mekanike. Ndërsa drita, përkundrazi, përhapet përmes valëve elektromagnetike, pa pasur nevojë për një mjedis fizik. Krahاسimi i tingujve dhe dritës tregon se tingulli ka nevojë për një mjedis material për t'u përhapur, ndërsa drita mund të përhapet edhe në vakum. Dëgjimi i tingullit dhe shikimi i dritës janë dy procese perceptuese që stimulojnë organe të ndryshme, si veshi dhe syri, për të interpretuar informacionin nga mjedisi.

Njohuritë

Aftësitë

Tingulli

Burimet e tingullit

- Përhapja e tingullit
- Krahاسimi i tingujve
- Dëgjimi i tingullit

Tingulli

Nxënësi:

- dallon tingujt natyrore dhe ato që krijohen nga njeriu në një mjedis përreth;
- dallon tingujt nga zhurmat;
- eksploron:
 - a) tinguj nga burime të ndryshme;
 - b) tinguj të ulët dhe të lartë;
- provon se tingulli:
 - a) përhapet duke u larguar nga burimi i tij në të gjitha drejtimet;
 - b) sa më larg burimit të përhapet, aq më pak dëgjohet;
 - c) dëgjohet kur mbërrin në veshin tonë.

4.2.4 Tematika: Elektriciteti dhe magnetizmi

Elektriciteti dhe magnetizmi	
Përshkrimi i tematikës: Përmes tematikës elektriciteti dhe magnetizmi nxënësit arrijnë të njohin pajisjet e thjeshta që punojnë me rrymë, si llambat, radio, etj.. Gjatë lojës dhe eksperimentimit, ato zbulojnë gjithashtu se magnetet tërheqin disa objekte prej metali, por jo ato prej druri apo plastike. Kjo i ndihmon të zhvillojnë mendimin shkencor dhe kuriozitetin për natyrën.	
Njohuritë	Aftësitë
- Pajisjet elektrike - Trupat magnetike dhe jo magnetikë	Nxënësi: <u>identifikon</u> objektet/ pajisjet që punojnë me elektricitet; <u>shpjegon</u> se çfarë ndodh kur magnetet afrohen dhe prekin trupa të përbërë nga materiale të ndryshme.

4.2.5 Tematika: Toka dhe hapësira

Toka dhe hapësira	
Përshkrimi i tematikës: Përmes kësaj tematike nxënësit kuptojnë se planeti Tokë, kryesisht është i mbuluar nga ujë, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga shkëmbinj dhe dhera. Toka është planeti ku ne jetojmë dhe ofron kushte të nevojshme për jetën, si ujë, ajër dhe temperatura të përshtatshme. Dielli, një nga shumë yjet e hapësirës, është burimi kryesor i nxehtësisë dhe dritës që mbështet jetën në Tokë. Toka është pjesë e sistemit diellor dhe ndodhet në një pozicion të favorshëm që lejon zhvillimin e jetës. Hapësira përreth Tokës është e mbushur me shumë objekte të tjera, duke përfshirë planetë të tjerë dhe yje të largët.	
Njohuritë	Aftësitë
Toka si planet	Nxënësi:

• Dielli si një yll mesatar	▪ <u>tregon</u> se planeti Tokë është i mbuluar kryesisht me ujë, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga shkëmbinj dhe dhera; ▪ <u>tregon</u> se Toka është planeti në të cilin ne jetojmë; ▪ <u>përshkruan</u> se Dielli është burim i nxehtësisë dhe dritës, si dhe një nga shumë yjet e hapësirës.
---	---

4.2.6 Tematika: Struktura dhe funksionimi i organizmave të gjallë

Struktura dhe funksionimi i organizmave të gjallë	
Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë nënvizon parimet themelore të strukturës dhe funksionit që janë të përbashkëta për të gjitha format e jetës. Nëpërmjet studimit të strukturës dhe funksionimit të organizmave të gjallë nxënësi fiton një kuptim më të thellë të mekanizmave bazë të jetës, nga niveli mikroskopik (qeliza) te organizmi, me sisteme të specializuara që kryejnë funksione jetësore të ndryshme dhe komplekse.	
Njohuritë	Aftësitë
Qëniet e gjalla • Bimët dhe kafshët si qenie të gjalla	▪ <u>vëzhgon</u> dhe krahason të gjallën nga jo e gjalla; ▪ <u>formulon</u> pyetje të thjeshta që e ndihmojnë të familjarizohet me proceset jetësore karakteristike të qenieve të gjalla; ▪ <u>përshkruan</u> përmes shembujve nga vëzhgimet se kafshët përfshirë dhe njeriun kanë nevojë për ujë, ajër dhe ushqim për të jetuar; ▪ <u>përshkruan</u> se bimët kanë nevojë për ujë dhe dritë për të jetuar;
Bimët • Pjesët e bimës	▪ <u>vëzhgon</u> dhe <u>identifikon</u> pjesët kryesore të bimëve si: rrënja, kërcelli/trungu, gjethja, lulja; ▪ <u>mbledh</u> dhe <u>regjistron</u> informacion nga vëzhgimet dhe eksperimentet me bimë për t'u dhënë

• Bimët dhe drita	përgjigje pyetjeve dhe për të nxjerrë vetë përfundime; ▪ <u>tregon kuriozitet</u> duke bërë pyetje dhe eksploruar bimët në mjedisin përreth.
Kafshët dhe njeriu ▪ Ngjashmëritë dhe ndryshimet midis njerëzve ▪ Shqisat	▪ <u>vëzhgon</u> dhe <u>identifikon</u> ngjashmëritë dhe ndryshimet midis njerëzve; ▪ <u>dallon</u> dhe <u>emërton</u> pjesët kryesore të jashtme të trupit të njeriut; ▪ <u>provon</u> se si përmes shqisave njerëzit dhe kafshët njohin botën rreth tyre..

4.2.7 Tematika: Materialet

Materialet	
Përshkrimi i tematikës: Kjo tematikë nënvizon rëndësinë e njohjes më thellë të gjithçkaje që na rrethon. Në përfundim të kësaj tematike nxënësi aftësohet të identifikojë, të emërtojë apo të përshkruaj dhe të krahasojë objektet bazuar në materialet që i përbëjnë. Në fokus të kësaj tematike është njohja e materialeve dhe struktura e tyre.	
Njohuritë	Aftësitë
▪ Klasifikimi i materialeve ▪ Lëndët rreth nesh	Nxënësi: ▪ <u>identifikon</u> dhe grupojnë materialet e zakonshme. ▪ <u>vëzhgon</u> dhe përshkruan përbërjen e objekteve të ndryshme në mjedisin përreth; ▪ <u>klasifikon</u> objektet dhe materialet sipas përbërjes së tyre; ▪ <u>kupton</u> ndryshimin midis një objekti dhe një materiali.

4.2.8 Tematika: Vetitë e materialeve

Vetitë e materialeve	
Përshkrimi i tematikës: Në tematikën “Vetitë e materialeve” janë trajtuar koncepte të rëndësishme shkencore ku përfshihen vetitë e materialeve të ndryshme , si dhe ndryshimet e materialeve pas veprimit fizik. Në përfundim të kësaj tematike nxënësi është i aftë të përshkruaj vetitë fizike dhe kimike të materialeve të jetës së përditshme.	
Njohuritë	Aftësitë
- Vetitë dhe karakteristikat e lëndëve - Ndryshimet e materialeve	Nxënësi: <u>kupton</u> se të gjitha materialet kanë një shumëllojshmëri të vetive fizike dhe kimike; <u>eksploron</u> dhe përshkruan vetitë fizike të materialeve të jetës së përditshme <i>p.sh</i> <i>transparenca, fortësia, elasticiteti, ashpërsia, vetia magnetike etj.</i>; <u>vëzhgon</u> dhe <u>klasifikon</u> materiale që thithin dhe nuk thithin ujë (<i>p.sh.: shami, letra, copa veshjesh, plastike, druri, metalike, qelqi etj</i>); <u>vëzhgon</u> dhe <u>përshkruan</u> materialet në bazë të vetive të tyre si: fortësia, butësia, ashpërsia, shkëlqimi metalik; <u>përshkruan</u> se si ndryshon materiali pas veprimit fizik (tërheqja, ngjeshja, përkulja, përdredhja etj.).

4.2.9 Tematika: Shkenca në praktikë

Përshkrimi i tematikës: Shkenca është një mënyrë sistematike e të kuptuarit të botës përmes vëzhgimit, eksperimentimit dhe arsyetimit logjik. Ajo ka evoluar nga konceptet filozofike të lashtësisë deri te teknologjitë moderne që përdorim sot. Përmes shkencës, nxënësit kuptojnë se si funksionojnë pajisjet dhe proceset në jetën e përditshme, nga telefonat inteligjentë te sistemet e energjisë. Ata njihen me rolin e shkencëtarëve,

inxhinierëve dhe profesionistëve të tjerë, të cilët përdorin metoda shkencore për të zgjidhur probleme dhe për të krijuar ide të reja. Tematika thekson edhe rëndësinë e shkencës në marrjen e vendimeve të informuara, si dhe në kuptimin e ndikimit të njeriut mbi mjedisin dhe planetin. Nxënësi:

- tregon si ka evoluar mendimi shkencor ndër vite;
- kupton si funksionojnë objektet që përdorim, duke u bazuar në parime shkencore;
- shpjegon se shkencëtarët përdorin metoda shkencore për zgjidhjen e problemeve;
- kupton se shkenca ndihmon për të kuptuar ndikimin e njeriut mbi botën përreth dhe rëndësinë e veprimeve të ndërgjegjshme.

4.3 Qëndrime dhe vlera

AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË	QËNDRIMET DHE VLERAT
✓ formulimi i hipotezës ✓ krijimi i mundësive ✓ parashikimi ✓ vrojtimi ✓ përdorimi i aparateve dhe pajisjeve ✓ krahasimi ✓ klasifikimi ✓ interpretimi ✓ shpjegimi ✓ analiza ✓ vlerësimi ✓ komunikimi	✓ kurioziteti ✓ krijimtaria ✓ integriteti ✓ objektiviteti ✓ mendjehapur ✓ këmbëngulja ✓ përgjegjshmëria

5 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve)

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të veprimtarive që mund të përdoren nga mësuesi për përmbushjen e rezultateve të të nxënit në tematika të ndryshme.

Tabela 3. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve

Rezultat të nxëni të orës mësimore	Shembuj të veprimtarive praktike Klasa I
Shembulli 1. Tema: Tingujt përreth nesh Nxënësi eksploron: a) tinguj nga burime të ndryshme; b) tinguj të ulët dhe të lartë.	Shembulli 1. Prezantimi i situatës: Mësuesi u thotë nxënësve: Imagjinoni që jeni zbulues të tingujve! Sot do të shkojmë në një udhëtim të veçantë për të zbuluar tingujt në mjedis. Hapni veshët dhe dëgjoni me kujdes gjithçka që ndodh përreth jush. Mund të dëgjoni zogjtë, makinat, hapat, apo ndoshta edhe erën. Le ta zbulojmë së bashku botën e tingujve! Eksplorimi praktik: Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe dalin në oborrin e shkollës ose qëndrojnë të qetë në klasë për 5 minuta për të dëgjuar tingujt. Çdo grup regjistron në një fletë (me ndihmën e mësuesit) tingujt që dëgjon (p.sh. zëri i mësueses, gjethet që lëvizin, kënga e zogjve, tingulli i kambanës së shkollës). Mësuesi ndihmon nxënësit të dallojnë tingujt natyrorë nga ata që krijohen nga njeriu. Përshkrimi dhe analiza: Grupet diskutojnë këto pyetje: ▪ Nga vinte tingulli? ▪ Ishte i fortë apo i lehtë?

	▪ Ishte i këndshëm apo i bezdisshëm? ▪ Si mendoni se krijohen tingujt? Prezantimi: Çdo grup prezanton tingujt që ka dëgjuar dhe ndan mendimet për to. P.sh.: Ne dëgjuam zërin e zogjve dhe erën që lëvizte pemët. Ishin tinguj të këndshëm dhe të qetë. Ne dëgjuam një makinë që kaloi pranë. Ishte një tingull i fortë dhe i zhurmshëm. Reflektimi: Mësuesi udhëzon nxënësit të reflektojnë përmes pyetjeve si: ▪ Pse është e rëndësishme të dëgjojmë me kujdes tingujt përreth nesh? ▪ Si mund të dallojmë tingujt e natyrës nga ata që krijohen nga njerëzit? ▪ Cilët tinguj ju pëlqyen më shumë dhe pse? ▪ Çfarë tingujsh nuk ju pëlqyen dhe si mund të kujdesemi për të pasur më pak zhurmë? ▪ A mund të dalloni tingujt nga zhurmat?
Shembull 2 Tema: Krahasimi i lëvizjes së trupave.	Shembull 2 <i>Tema:</i> Krahasimi i lëvizjes së trupave Prezantimi i situatës: Mësuesi u drejtohet nxënësve: Imagjinoni se jeni në një kënd lojërash. Disa fëmijë po rrëshqasin në rrëshqitëse, disa po rrokullisin topa, të tjerë po lëvizin biçikletat e tyre ose kërcejnë me litar. A lëvizin të gjitha në të njëjtën mënyrë? A mund të dalloni si ndryshon lëvizja e tyre? Sot do të zbulojmë se si lëvizin trupat dhe si mund t'i krahasojmë! Veprimtari eksploruese:

	Materialet: Mësuesi sjell në klasë ose tregon figura/objekte si: top, biçikletë lodër, kuti, libër, makinë lodër, tullumbace, rrotë, kub druri, lodër që kërce. Puna në grupe: Nxënësit punojnë me objektet për t'i lëvizur në një sipërfaqe të sheshtë. Ata vëzhgojnë si lëviz secili objekt kur e shtyjnë ose e lënë të bjerë. Klasifikimi: Grupet i ndajnë objektet sipas mënyrës së lëvizjes në 3 kategori: ✓ Rrokullisen (topi, rrota) ✓ Rrëshqasin (libri, kuti) ✓ Kërcejnë (lodra që kërce, tullumbace e fryrë) Përshkrimi dhe diskutimi: Çdo grup shpjegon zgjedhjet e veta: Ne vumë topin te trupat që rrokullisen, sepse ai lëviz duke u rrotulluar Kutia rrëshqet, nuk rrotullohet, kështu që e vumë te trupat që rrëshqasin. Mësuesi udhëzon diskutimin me pyetje si: ▪ A mund të lëvizë një trup në më shumë se një mënyrë ▪ Si ndikon forma e trupit në mënyrën e lëvizjes ▪ Çfarë ndodh nëse e shtyjme fort apo butë? Prezantimi: Grupet përgatisin një fletë/poster me vizatime ose figura dhe i vendosin në tabelë nën kategoritë: Rrokulliset Rrëshqet Kërce
--	--

	Nxënësit shpjegojnë zgjedhjet para klasës. Reflektimi: Mësuesi udhëzon klasën me pyetje për të nxitur të menduarit: ▪ Pse është e rëndësishme të dimë si lëvizin trupat? ▪ Si ndihmon kjo njohuri në jetën e përditshme? ▪ A mund të lëndohemi nëse nuk e dimë si lëvizin trupat?
Shembulli 3 Nxënësi: <u>Identifikon</u> objektet/pajisjet që punojnë me elektricitet.	<i>Shembull 3</i> Titulli: “Objektet që punojnë me rrymë elektrike” Prezantimi i situatës: Mësuesi u drejtohet nxënësve: Imagjinoni që është errësirë dhe gjithçka është fikur në shtëpi. Nuk ndizen llambat, frigoriferi nuk punon, televizori nuk ndizet. Çfarë ka ndodhur? Po sikur të mos kishim rrymë elektrike, si do ishte jeta jonë? Le të zbulojmë së bashku se cilat pajisje na ndihmojnë çdo ditë dhe si punojnë ato! Veprimtari eksploruese: Mësuesi sjell në klasë ose tregon figura të objekteve si: llambë, frigorifer, televizor, kompjuter, lavatriçe, telefon, radio, sobë elektrike. Nxënësit punojnë në grupe dhe ndajnë pajisjet në dy kategori: Pajisje që punojnë me rrymë elektrike. Pajisje që nuk kanë nevojë për rrymë (si libri, topi, furça e dhëmbëve). Përshkrimi dhe diskutimi: Çdo grup shpjegon pse e vendosi një pajisje në një nga kategoritë. Diskutohet: “Si e kuptojmë që një pajisje ka nevojë për rrymë?” (ka prizë, buton, drita që ndizen, zhurmë etj.) Prezantimi: Grupet paraqesin postera ose fletë me pamjet dhe shpjegojnë ndarjen e tyre.

	P.sh.: Ne kemi vendosur televizorin te pajisjet që punojnë me rrymë sepse ai ndizet me buton dhe ka nevojë për prizë. Libri nuk ka nevojë për rrymë, sepse mund ta lexojmë pa e ndezur. Reflektimi: Mësuesi i udhëzon me pyetje si: Pse është e rëndësishme të dimë cilat pajisje kanë nevojë për rrymë? Çfarë ndodh nëse keqpërdorim pajisjet elektrike? Si mund të kujdesemi që të përdorim rrymën në mënyrë të sigurt?
Shembull 4 Nxënësi <u>provon</u> sesi përmes shqisave njerëzit dhe kafshët njohin botën rreth tyre.	Shembull 2. Tema: Treni i shqisave Prezantimi i situatës: Mësuesi/ja fillon duke pyetur nxënësit: "Si e kuptoni ju se çfarë ndodh rreth jush? Si e dini nëse diçka është e nxehtë apo e ftohtë? Si e dalloni lulen nga lodra juaj e preferuar?" (Inkurajohen përgjigjet e nxënësve). Në vijim mësuesi/ja pyet: "A mendoni se edhe kafshët e përdorin shikimin, dëgjimin, nuhatjen, prekjen dhe shijen për të njohur botën rreth tyre? Si mendoni se e përdor një qen hundën? Si e përdor një mace sytë?" (Inkurajohet diskutimi i shkurtër). Përshkrimi praktik: Eksplorimi përmes shqisave Mësuesi/ja organizon klasën në pesë stacione të ndryshme, secili dedikuar një shqisë. Nxënësit, në grupe të vogla, vizitojnë secilin stacion dhe kryejnë aktivitete të thjeshta: Stacioni i shikimit: Nxënësit shikojnë objektet e ndryshme, përshkruajnë ngjyrat dhe format. Shikojnë fotot e kafshëve dhe diskutojnë se si shikimi i ndihmon ato.

	Stacioni i dëgjimit: Nxënësit dëgjojnë tingujt e instrumenteve, regjistrimet e kafshëve dhe zhurmat e tjera. Provojnë të dallojnë tingujt. Diskutojnë se si dëgjimi i ndihmon kafshët (p.sh., të dëgjojnë rrezikun). Stacioni i nuhatjes: Nxënësit nuhasin objektet me aroma të ndryshme dhe përpiqen t'i identifikojnë. Diskutojnë se si nuhatja i ndihmon kafshët (p.sh., të gjejnë ushqimin). Stacioni i prekjes: Nxënësit prekin objektet me tekstura të ndryshme dhe përshkruajnë si ndihen. Diskutojnë se si prekja i ndihmon kafshët (p.sh., të njohin të vegjlit e tyre). Stacioni i shijes: Nxënësit provojnë copat e vogla të ushqimeve dhe përshkruajnë shijet. Diskutojnë se si shija i ndihmon kafshët (p.sh., të dallojnë ushqimin e sigurt). Mësuesi sigurohet që çdo nxënës të ketë mundësinë të provojë, por pa u detyruar. Pas vizitës në çdo stacion, mësuesi/ja inkurajon një diskutim të shkurtër rreth asaj që provuan dhe mësuan. Reflektimi. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të reflektojnë duke theksuar rëndësinë e secilës shqisë për të njohur dhe kuptuar mjedisin përmes pyetjeve: “Çfarë mësua sot për mënyrën si ne dhe kafshët njohim botën rreth nesh?” “Si i përdorni ju shqisat tuaja çdo ditë?” “Si mendoni se i përdorin kafshët shqisat e tyre për të gjetur ushqim, për t'u mbrojtur ose për të luajtur?”.
Shembull 5 Nxënësi kupton se të gjitha objektet përbëhen nga materiale dhe i identifikon ato.	Titulli: “Të gjitha objektet përbëhen nga materiale” Prezantimi i situatës: Mësuesi e nis veprimtarinë duke ju shpjeguar nxënësve se çfarë janë materialet dhe rëndësinë e tyre në jetën e përditshme. Të gjitha objektet që na rrethojnë përbëhen nga materiale të ndryshme. Çdo material ka vetitë e tij. Me të njëjtin material krijohen objekte të ndryshme. Në klasën tonë gjenden objekte të llojeve të ndryshme. Le ti grupojmë ato sipas materialeve dhe vetive të përbashkëta.

	Përshkrimi praktik: Veprimtari eksploruese Mësuesi u kërkon nxënësve të vëzhgojnë rreth e rrotull klasës së tyre dhe të identifikojnë objektet që klasa përmban, më pas të përzgjedhin dy objekte me materiale të ndryshme. Nxënësit punojnë në grupe dhe krahasojnë objektet me njëri-tjetrin: Çfarë kanë të përbashkët ? Çfarë kanë të ndryshme ? Përshkrimi dhe diskutimi: Në secilin grup nxënësit diskutojnë për objektet që kanë vëzhguar dhe që kanë grupuar sipas materialeve të përbashkëta. Çdo grup shpjegon grupimet e përzgjedhura duke përshkruar vetitë e materialeve nga të cilat përbëhen këto objekte. Secili nga grupet e krijuara u tregojnë nxënësve të klasës se çfarë vunë re . Secili nxënës prezanton sendet e zgjedhura dhe përshkruan karakteristikat e përbashkëta të materialeve përbërëse të këtyre objekteve. Reflektimi: Mësuesi i udhëzon nxënësit të: Përdorni shqisat e të parit apo prekurit për të grupuar objektet përreth. Me cilat shqisa i dallove vetitë e materialeve të objekteve të tua? Identifiko objektet dhe kërko prej shokëve të gjejnë veti që e karakterizojnë materialet e këtyre objekteve.
--	--

Në udhëzuesit kurrikularë të lëndës Dituri Natyre do të përshkruhen veprimtari praktike që synojnë përmbushjen e rezultateve të të nxënës, të strukturuar sipas tematikave përkatëse të lëndës.

6 Metodologjia e mësimdhënies

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies në fushën e shkencave natyrore janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme, që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të nxënësve.

Mësimdhënia e bazuar në kompetenca kërkon që, në përzgjedhjen dhe zbatimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesit të:

- marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve, që nënkupton përvojat individuale të tyre dhe, mbi këtë bazë, të mbështesin e orientojnë të nxënësve të tyre;
- nxisin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve, vëzhgimeve në natyrë dhe eksperimenteve;
- nxisin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- motivojnë nxënësit, duke i konsideruar si partnerë, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë komplementarë të njëri-tjetrit;
- mbështesin të nxënësit e pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
- mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të shkencave natyrore, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore;
- shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës;
- përdorin teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) si mbështetje të procesit mësimor.

Të nxënësve me situata kontekstuale si metodologji mësimore

Të nxënësve me situata si metodologji mësimore, vë më shumë theksin tek konteksti dhe zbatimi i njohurive se sa te memorizimi i fakteve. Të

nxënit në shkencat e natyrës, fillon kur nxënësit përpiqen të zgjidhin probleme dhe të eksplorojnë situata të jetës reale për të gjetur përgjigjet e pyetjeve që lindin.

Pikënisje për planifikimin e situatave të nxënit nga mësuesit janë rezultatet e të nxënit që synojnë kompetencat. Mësuesi saktëson rezultatet e pritshme të nxënësve të tij mbi bazën e kërkesave të kurrikulës së shkencave të natyrës. Për planifikimin e situatave mësuesi duhet të marrë gjithashtu parasysh njohuritë paraprake të nxënësve. Këto janë kusht jo vetëm për përvetësimin e njohurive të reja, por dhe për të aftësuar nxënësit të përdorin njohuritë. Për këtë mësuesi ndërton situata duke u mbështetur në situata të nxëni reale ose të ngjashme me realitetin për çështje specifike globale, lokale ose personale të lidhur me shkencën.

Siguria

Mësuesit janë përgjegjës për sigurinë e nxënësve gjatë veprimtarive, si brenda ashtu edhe jashtë klasës, për nxitjen dhe motivimin e tyre për rregullat dhe përgjegjësitë e sigurisë.

Gjatë veprimtarive në fushën e shkencës, nxënësit zbatojnë gjithmonë dhe në mënyrë të ndërgjegjshme rregullat e sigurisë në shkollë, klasë dhe jashtë tyre; identifikojnë paraprakisht kushtet në të cilat veprimtaria mund të mos jetë e sigurt dhe tregojnë se si mund të parandalohen aksidentet në të gjitha rastet e mundshme; përdorin pajisjet, kimikatet dhe mjetet sipas udhëzimeve; tregojnë vazhdimisht shqetësim për sigurinë e tyre dhe të tjerëve.

Integrimi i TIK-ut në kurrikul

TIK-u përdoret në mësimdhënie si metodë dhe mjet mësimor, me qëllim rritjen e efikasitetit të të nxënit. Nxënësit përdorin TIK-un për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar, analizuar dhe shkëmbyer informacione nëpërmjet kompjuterit dhe internetit. Integrimi i teknologjisë dhe përdorimi i burimeve të reja digjitale inkurajon shkëmbimin e ideve, krijimin e projekteve, zgjidhjen e problemeve, si dhe ndihmon përmirësimin e aftësive të mendimit krijues nëpërmjet një qasjeje më moderne dhe inovatore gjatë mësimdhënies. Përmes përdorimit të pajisjeve digjitale nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte si dhe zbulojnë marrëdhënien ndërmjet koncepteve, dukurive dhe ligjeve.

Platformat interaktive

Platformat interaktive në mësimdhënien dhe nxënien e shkencave të natyrës ofrojnë mjedise digjitale me aplikacione, softuerë, video-lojëra, simulime interaktive, dhe materiale multimediale. Këto mjedise ndihmojnë në lehtësimin e procesit të nxënësve, duke rritur aftësinë e nxënësve për të eksploruar dhe perceptuar saktë konceptet abstrakte. Platformat interaktive gjithashtu nxisin interesin e nxënësve dhe inkurajojnë gjithëpërfshirjen, ndërveprimin, të menduarin kritik dhe krijues, si dhe promovojnë punën kërkimore shkencore. Qëllimi është që nxënësit të kuptojnë thellësisht kontekstin e konceptit, duke hulumtuar dhe zbuluar dukuritë natyrore, duke bërë të padukshmen të dukshme. Kjo qasje inkurajon nxënësit të mësojnë në një mënyrë më të pavarur dhe të angazhohen në një mësim më efektiv dhe produktiv.

6.1 Roli i situatave të të nxënësve praktike nga jeta reale

Një ndër mënyrat më efektive për të ndërtuar kuptim të thelluar dhe të qëndrueshëm shkencor në arsimin fillor është përfshirja e situatave reale dhe praktike në procesin e të nxënësve. Kur nxënësit përballen me probleme konkrete të jetës së përditshme, si: përlogaritja e shpenzimeve të një udhëtimi, krahasimi i ofertave ekonomike, menaxhimi i buxhetit personal, matja e kohës dhe distancës, ose analiza e të dhënave statistikore në media, ata kuptojnë se Dituria e Natyrës është një mjet jetik për të kuptuar dhe përballuar sfidat e jetës së përditshme, jo thjesht një lëndë shkollore. Konteksti real e bën mësimin më kuptimplotë dhe funksional, duke i ndihmuar nxënësit që :

- ✓ *të kuptojnë vlerën praktike dhe shoqërore të diturisë natyrës*, si një mjet për marrjen e vendimeve të arsyetuara dhe për përballimin e situatave nga më të thjeshtat deri te ato komplekse;
- ✓ *të zhvillojnë mendimin logjik, kritik dhe krijues*, duke analizuar situata, duke krahasuar mundësi dhe duke gjetur zgjidhje alternative për probleme të ndryshme.
- ✓ *të ndërtojnë aftësi të zgjidhjes së problemeve në mënyrë të pavarur*, duke ndjerë siguri dhe besim në zbatimin e njohurive shkencore në botën reale, jashtë klasës.
- ✓ Në këtë mënyrë, mësimi i diturisë natyrës tejkalon kufijtë e fletoreve, tabelës dhe librave, duke u shndërruar në një proces jetësor, që i ndihmon nxënësit të ndërtojnë kompetenca funksionale për të ardhmen, të nevojshme për të kuptuar dhe për t'u përballur me realitetin dinamik të përditshmërisë dhe botës së punës.

6.2 Roli i projekteve kurrikulare

Projektet kurrikulare përbëjnë një komponent të rëndësishëm të procesit mësimor në Diturinë e Natyrës, pasi i japin mundësi nxënësve të zbatojnë njohuritë e fituara në mënyrë të pavarur, funksionale dhe krijuese, përtej detyrave standarde të tekstit shkollor. Përmes projekteve kurrikulare, nxënësit sfidohen të përdorin konceptet shkencore për të zgjidhur probleme reale, duke zhvilluar aftësi si: mendimi kritik, planifikimi strategjik, punë në ekip, komunikimi dhe përdorimi i teknologjisë.

Projektet mund të ndërtohen rreth temave që lidhen drejtpërdrejt me jetën e përditshme, si:

- *Eksplorimi i burimeve të tingujve dhe perceptimi i tyre përmes shqisave*

Këto projekte thellojnë kuptimin e koncepteve dhe tregojnë se Dituria e Natyrës është një mjet praktik për zgjidhjen e problemeve reale dhe për marrjen e vendimeve të arsyetuara në jetën e përditshme.

Në këtë proces, roli i mësuesit është ai i *udhëheqësit/organizuesit dhe mentorit*, duke i ndihmuar nxënësit që:

- të formulojnë pyetje hulumtuese;
- të planifikojnë hapat e punës;
- të mbledhin dhe të analizojnë të dhëna;
- të interpretojnë rezultatet;
- të prezantojnë në mënyrë të qartë përfundimet e tyre.


Projektet gjithashtu ofrojnë mundësi për integrim ndërdisiplinor, duke lidhur Diturinë e Natyrës me: matematikën, teknologjinë, ekonominë, gjeografinë apo edukimin qytetar. Kjo i përgatit nxënësit për sfida reale që kërkojnë mendim kompleks dhe bashkëpunim.

Në diagramin 3 jepet shembulli i një situatë të nxëni nga jeta reale që mund të përdoret si ide edhe për projektin kurrikular.

Diagrama 3. Shembull situatë të nxëni dhe lidhja me elementet e programit

Situata e të nxënit:

Nxënësve u krijohet mundësia të zhvillojnë një ekskursion në brigjet e një lumi. Ata vëzhgojnë dhe diskutojnë mbi *sistemet natyrore* (lumi dhe tiparet e tij), *shumëllojshmërinë* dhe *klasifikimin e gjallesave* (kafshët dhe bimët e lumit), *diversitetin* e *materialeve* (uji dhe vetitë e tij), *ndërveprimin e trupave* (shpejtësia dhe trajektoria e rrjedhjes së ujit të lumit), *ndërveprimin me mjedisin* (ndotja e ujit, mbrojtja e lumenjve).



6.3 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta

Në mësimin e Diturisë së Natyrës, është e rëndësishme që të gjithë nxënësit të ndihen të përfshirë. Disa nxënës mund të përballen me sfida që lidhen me të kuptuarit e koncepteve abstrakte, me ritmin e të mësuarit ose me aftësitë për të zbatuar njohuritë në. Roli i mësuesit është të ofrojë mbështetje të personalizuar dhe të krijojë mjedise që nxisin zhvillimin e këtyre aftësive, duke përdorur qasje të ndryshme si:

- ofrimi i ushtrimeve të përshtatura dhe graduale që përforcojnë kuptimin bazë të koncepteve;
- përdorimi i mjeteve konkrete, ilustrimeve, skemave, vizualizimeve dhe simulimeve digjitale që ndihmojnë nxënësit të lidhin abstraksionin me përvojën konkrete;
- organizimi i punës në grupe të vogla ose në çift, duke inkurajuar ndihmën dhe shkëmbimin e ideve mes nxënësve;
- ofrimi i udhëzimeve të qarta dhe strukturimit të pyetjeve që nxisin të menduarit hap pas hapi;
- përdorimi i teknologjisë arsimore (aplikacione, platforma, video mësimore) që ofrojnë mundësi të ndryshme për t'u praktikuar.

6.4 Puna me nxënësit e talentuar

Nxënësit që tregojnë interes të shtuar dhe aftësi të avancuara në matematikë shpesh kanë nevojë për detyra dhe sfida që i ndihmojnë të thellojnë të kuptuarit, të zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues, si dhe të zbatojnë njohuritë në mënyrë fleksibël në situata të reja. Mësuesi, ka rolin e udhëheqësit dhe motivuesit, duke i inkurajuar këta nxënës që:

- të përballen me detyra të hapura, që lejojnë më shumë se një mënyrë zgjidhjeje dhe që kërkojnë analiza të thelluara dhe krahasime;
- të krijojnë vetë probleme shkencore, skenarë ose pyetje që nxisin zgjidhje kreative dhe të argumentuara;
- të marrin pjesë në diskutime, debate ose analiza shkencore për të shprehur dhe mbrojtur idetë e tyre;
- të angazhohen në lojëra logjike, sfida mendore, ose ushtrime që stimulojnë mendimin deduktiv dhe aftësitë analitike;
- të marrin pjesë në konkurse, olimpiada shkencore, sfida të shkencës apo projekte bazuar në qasjen STEM.

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën Dituri Natyre do të përshkruhen në mënyrë të detajuar veprimtari praktike dhe qasje metodologjike për zbatimin efektiv të mësimdhënies në përputhje me nevojat e të gjithë nxënësve.

7 Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi i nxënësve në arsimit fillor është pjesë e rëndësishme e procesit mësimor. Ai ndihmon mësuesin të kuptojë sa mirë mësojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat e kësaj lënde. Qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm vendosja e një note, por:

- t'i japë nxënësit mundësi të kuptojë progresin, të mësojë nga gabimet dhe të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë, si dhe të motivohet për të ecuar përpara;
- të ndihmojë mësuesin të kuptojë sa mirë nxënësit i kanë kuptuar koncepte dhe po i zbatojnë ato;
- të ndihmojë mësuesin të përmirësojë mënyrën e mësimdhënies.

7.1 Llojet e vlerësimit

Vlerësimi diagnostikues (vlerësimi si proces të nxënësi)

Zbatohet në fillim të vitit shkollor ose të një kapitulli të ri. Mësuesi zbulon njohuritë që nxënësi ka dhe identifikon çfarë ka nevojë të përsëritet ose të mësohet më mirë. Ky vlerësim ndihmon mësuesin të planifikojë më mirë mësimin, duke përshtatur ritmin dhe mënyrat e punës me nevojat e nxënësve.

Ky vlerësim mund të realizohet:

- ✓ me pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta;
- ✓ me ushtrime të shkurtra orientuese;
- ✓ me kuice të shkurtra;
- ✓ me lojëra ose biseda reflektuese,
- ✓ fisha vetëvlerësimi, etj.

Vlerësimi formues (vlerësimi i vazhduar, vlerësimi për të nxënë)

Zbatohet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, për të parë si po ecin nxënësit. Ai ndihmon nxënësit dhe mësuesin të kuptojnë nëse janë në rrugën e duhur dhe çfarë duhet përmirësuar në punën e tyre para se të arrijnë vlerësimin përmbledhës ose përfundimtar.

Teknika të vlerësimit formues janë:

- ✓ vlerësimi i punës në grupe;
- ✓ vëzhgimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes gjatë mësimit;
- ✓ detyrat e përditshme dhe projektet e vogla;
- ✓ vlerësimi i diskutimeve dhe argumentimi i zgjidhjeve;
- ✓ vlerësimi i përgjigjeve gjatë mësimit;
- ✓ vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët, etj.

Vlerësimi përmbledhës (vlerësimi periodik, vlerësimi i të nxënit)

Ky vlerësim bëhet pas një periudhe mësimore, ose pas një kapitulli dhe mat atë që nxënësi ka arritur të mësojë. Mund të realizohet me teste, detyra individuale me shkrim, projekte përmbyllëse. Kjo zakonisht shoqërohet me notë dhe ndihmon mësuesin, nxënësin dhe prindërit të kuptojnë progresin dhe arritjet.

7.2 Parime të rëndësishme të vlerësimit të nxënësit

- Vlerësimi duhet të ndihmojë nxënësit të mësojnë më mirë, të kuptojnë dhe të reflektojnë mbi gabimet e tyre.
- Detyrat dhe pyetjet e vlerësimit duhet të matin aftësitë dhe njohuritë që nxënësit duhet të zhvillojnë sipas kompetencave shkencore.
- Vlerësimi duhet të jetë i qartë dhe i drejtë për të gjithë nxënësit, pavarësisht aftësive të tyre.
- Vlerësimi duhet të inkurajojë nxënësit të besojnë në vetvete dhe të kuptojnë që gabimi është pjesë e të nxënit.
- Mësuesi duhet të përdorë shumë forma vlerësimi, si: përgjigjet me gojë, ushtrimet, punën me materiale konkrete, projektet, vizatimet, punën në grup, detyrat e shtëpisë etj.

Ky proces ndihmon që, vlerësimi të bëhet një mjet i dobishëm dhe i kuptueshëm për të gjithë, jo vetëm një "kontroll" për notë, por një mënyrë për të ndihmuar nxënësit të rriten dhe të përmirësohen.

7.3 Shembuj të niveleve të arritjes (RN-ve)

Në këtë rubrikë paraqiten shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit në tematika të ndryshme.

Tabela 4. Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e RN-ve

Shembull 1. Rezultati i të nxënit (RN): Nxënësi identifikon objektet dhe pajisjet që punojnë me elektricitet				
Niveli 1: <i>Arritje të pakënaqshme</i>	Niveli 2: <i>Arritje që kanë nevojë për përmirësim</i>	Niveli 3: <i>Arritje të kënaqshme</i>	Niveli 4: Arritje shumë të kënaqshme	Niveli 5: Arritje të shkëlqyera
<i>Nxënësi nuk dallon pajisjet që funksionojnë me elektricitet nga ato që punojnë pa elektricitet.</i>	<i>Nxënësi përmend disa pajisje elektrike me ndihmën e mësuesit ose në situata të njohura.</i>	<i>Nxënësi identifikon pajisje të thjeshta që funksionojnë me elektricitet në ambientin e shtëpisë apo klasës.</i>	<i>Nxënësi dallon qartë pajisjet elektrike nga ato që nuk punojnë me elektricitet dhe jep shembuj si përdoren në jetën e përditshme.</i>	<i>Nxënësi identifikon në mënyrë të pavarur pajisjet elektrike dhe shpjegon përdorimin e tyre, duke treguar shumë kujdes dhe siguri në përdorimin e tyre.</i>
Shembull 2 . Rezultati i të nxënit (RN): Nxënësi përshkruan se Dielli është burim i nxehtësisë dhe dritës, si dhe një nga shumë yjet e hapësirës.				
Niveli 1: <i>Arritje të pakënaqshme</i>	Niveli 2: <i>Arritje që kanë nevojë për përmirësim</i>	Niveli 3: <i>Arritje të kënaqshme</i>	Niveli 4: Arritje shumë të kënaqshme	Niveli 5: Arritje të shkëlqyera

<i>Nxënësi nuk e di që Dielli është burim drite dhe nxehtësie.</i>	<i>Nxënësi tregon se Dielli është burim drite dhe nxehtësie, por nuk e lidh plotësisht me rolin e tij në natyrë.</i>	<i>Nxënësi përshkruan Diellin si burim të dritës dhe nxehtësisë në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme.</i>	<i>Nxënësi shpjegon, se Dielli është burim natyror i dritës dhe nxehtësisë dhe tregon se ndodhet në hapësirë.</i>	<i>Nxënësi shpjegon qartë se Dielli është një yll në hapësirë dhe burim i dritës e nxehtësisë për Tokën, duke treguar kuptim të plotë të rolit të tij.</i>
Shembull 3. Rezultati i të nxënit: <i>Nxënësi provon sesi përmes shqisave njerëzit dhe kafshët njohin botën rreth tyre.</i>				
Niveli 1: <i>Arritje të pakënaqshme</i>	Niveli 2: <i>Arritje që kanë nevojë për përmirësim</i>	Niveli 3: <i>Arritje të kënaqshme</i>	Niveli 4: <i>Arritje shumë të kënaqshme</i>	Niveli 5: <i>Arritje të shkëlqyera</i>
<i>Nxënësi përmend vetëm disa shqisa të thjeshta (si p.sh., të parit dhe të dëgjuarit) pa treguar përmes shembujve se si ato ndihmojnë në njohjen e mjedisit.</i>	<i>Nxënësi përmend disa nga shqisat e përdorura nga njerëzit dhe kafshët (të paktën tre) dhe jep shembuj të thjeshtë se si ato përdoren për të ndërvepruar me botën.</i>	<i>Nxënësi shpjegon me shembuj specifikë se si njerëzit dhe kafshët përdorin shqisat për të marrë informacion nga mjedisi.</i>	<i>Nxënësi provon sesi përmes shqisave njerëzit dhe kafshët njohin botën rreth tyre.</i>	<i>Nxënësi provon me shembuj nga jeta e përditshme se si shqisat e ndihmojnë njerëzit dhe kafshët të njohin mjedisin rreth tyre.</i>

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën Dituri Natyre, nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit (RN-ve) përshkruhen sipas tematikave të lëndës.

8 Burimet dhe materialet didaktike

Gjatë procesit të mësimdhënies së lëndës “Dituria e Natyrës”, përdorimi i burimeve dhe materialeve të ndryshme ndihmon në ndërtimin e një kuptimi të thelluar dhe praktik të koncepteve shkencore. Këto burime ndihmojnë në aktivizimin e të gjitha shqisave të nxënësve, duke e bërë të nxënësit më interaktiv, të prekshëm dhe të kuptueshëm. Llojet e burimeve që mund të përdoren përfshijnë:

- *Materiale vizuale*: figura, tabela, harta konceptesh, postera, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.
- *Objekte reale*: klasa, laborator, tabela interaktive, kabinetet e punës, natyra, ferma.
- *Mjete teknologjike*: projektorë, kompjuterë, tableta, lojëra digjitale apo platforma mësimore online.

Gjatë shpjegimit, mësuesi duhet të përdor një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, fjali të shkurtra dhe një fjalor të përshtatur për moshën dhe nivelin e nxënësve. Ai/ajo duhet të përzgjedhë shembuj konkretë dhe ushtrime të personalizuar, duke siguruar mbështetje shtesë sipas nevojave që kanë nxënësit.

Përveç tekstit shkollor, mësuesi *përdor edhe: fletore pune, materiale ndihmëse, ushtrime shtesë dhe platforma digjitale*, që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe të zbatojnë më mirë diturinë e natyrës.

Libri i nxënësit mbetet burimi bazë, pasi përmban veprimtaritë mësimore të strukturuar sipas temave.

8.1 Përdorimi i teknologjisë dhe qasjes STEM

Në arsimin fillor, integrimi i teknologjisë në mësimdhënie përforcon zhvillimin e mendimit logjik, të të menduarit kritik dhe të aftësisë për zgjidhjen e problemeve. Qasja **STEM** (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) inkurajon nxënësit *të sillen si studiues e krijues, duke përdorur teknologjinë si mjet ndihmës për të analizuar dhe zgjidhur situata reale*. Klasat e pajisura me mjete si: tabela interaktive, laboratorë digjitalë dhe platforma edukative, ndihmojnë në krijimin e një mjedisi mësimor bashkëkohor dhe motivues, ku lënda e diturisë së natyrës mësohet në mënyrë aktive dhe funksionale. Format kryesore të përdorimit të TIK-ut dhe STEM-it përfshijnë:

- *Përdorimin e programeve mësimore dhe lojërave digjitale*. Nxënësit përdorin aplikacione, softuer edukative për të ndërtuar figura, tabela, grafikë, krijuar eksperimente dhe për të zgjidhur ushtrime të ndryshme në mënyrë argëtuese dhe të kuptueshme.

- *Përdorimin e burimeve online dhe platformave interaktive.* Nxënësit mësojnë duke përdorur platforma edukative që ofrojnë mësimë interaktive, sfida shkencore dhe ushtrime të përshtatura për nivelin e tyre, duke i dhënë mundësi për të mësuar me ritmin e tyre.
- *Bashkëpunimin për projekte STEM.* Nëpërmjet projekteve të vogla STEM me kontekst real, nxënësit punojnë në grup për të zgjidhur probleme që kërkojnë përdorimin e njohurive nga matematika, shkenca dhe teknologjia, duke forcuar kompetencat sociale dhe ndërdisiplinore.
- *Përdorimin etik dhe të sigurt të teknologjisë.* Nxënësit mësojnë të përdorin teknologjinë me përgjegjësi, duke respektuar të drejtën e autorit, privatësinë dhe normat e komunikimit etik në mjediset digjitale. Ata mësojnë si të jenë të sjellshëm.

Qasja STEM i ndihmon nxënësit jo vetëm të mësojnë shkencën , por edhe të mësojnë të mendojnë si hulumtues, shpikës dhe zgjidhës problemesh, duke lidhur shkencën me jetën reale, shkencën, teknologjinë dhe inxhinierinë. Në këtë mënyrë, lënda e Diturisë së Natyrës bëhet më e bukur dhe e dobishme për të ardhmen!

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e Diturisë së Natyrës do të përshkruhet përdorimi i burimeve dhe materialeve didaktike, përfshirë teknologjinë.

9 Rekomandime për zbatimin e programit

Programi bazë për lëndën “**Dituria e Natyrës**” është hartuar sipas Kornizës Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar, Kurrikulës Bërthamë dhe planeve mësimore të arsimit bazë, duke përfshirë edhe rekomandimet e Bashkimit Evropian. Ky dokument u shërben mësuesve, autorëve të teksteve mësimore, hartuesve të testeve kombëtare, vlerësuesve të jashtëm të cilësisë, prindërve, nxënësve. Në këtë kapitull përshkruhen disa rekomandime për zbatuesit e programit.

a) Rekomandime për mësuesit

- ✓ Të lidhin përmbajtjen e diturisë natyrës me fusha të tjera (shkencë, teknologji, inxhinieri, art, gjuhë, edukatë qytetare, etj.) për të ndihmuar kuptimin e thelluar dhe zbatimin praktik të koncepteve dhe për të kuptuar profesione të ndryshme.
- ✓ Të përdorin qasjen STEM përmes projekteve, eksperimenteve dhe zgjidhjes së problemeve reale.
- ✓ Të krijojnë aktivitete praktike që e ndihmojnë nxënësin të kuptojë përdorimin e diturisë natyrës në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me profesione të ndryshme.
- ✓ Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për fëmijët me aftësi me talente.
- ✓ Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socioemocional.
- ✓ Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata nga pakicat kombëtare dhe grupe të marginalizuara.
- ✓ *Të sigurojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të diturisë natyrës (p.sh. sugjerohet 60% teori — 40% praktikë). Përdorimi praktik i diturisë natyrës do të realizohet jo vetëm në orët e veçanta si: ushtrime, përsëritje, projekte, konkurse etj., po përgjatë çdo ore mësimore. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.*
- ✓ Të përfshijnë platforma digjitale interaktive për mësimin e lëndës “Dituri Natyre”.
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së teksteve shkollore.
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë për lëndën “Dituri Natyre”.
- ✓ Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

b) Rekomandime për autorët e teksteve shkollore

- ✓ Të përshtatin në mënyrë cilësore tekstet shkollore duke reflektuar të gjitha përditësimet më të fundit.
- ✓ Të përfshijnë platforma digjitale interkative për mësimin e diturisë natyrës, në tekstet shkollore.
- ✓ Të sigurojnë librat origjinal të mësuesit si pjesë e paketës së tekstit shkollor.
- ✓ Të sigurojnë materialet burimore edhe digjitale për zbatimin e tekstit shkollor.
- ✓ Të lidhin konceptet shkencore me fusha të tjera dhe me situata të jetës reale, në tekstet shkollore.
- ✓ Të përfshijnë në tekstet shkollore ushtrime që promovojnë mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve dhe krijimtarinë edhe në kuadër të zbatimit të qasjes STEM.
- ✓ Të krijojnë hapësirë në tekstet shkollore për shembuj dhe ushtrime që nxisin orientimin për karrierë, përmes profesioneve ku matematika luan rol.
- ✓ Të sigurojnë që tekstet të kenë qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për moshën, duke marrë parasysh diversitetin kulturor dhe aftësitë e ndryshme të nxënësve.

c) Rekomandime për hartuesit e testeve kombëtare

- ✓ Të sigurojnë që testet të përmbajnë jo vetëm ushtrime teorike, por edhe ushtrime me zbatime praktike në jetën reale.
- ✓ Të integrojnë qasje ndërdisiplinore, që nxisin të menduarit logjik, të menduarin kritik dhe krijues, jo thjesht memorizimin.
- ✓ Të përfshijnë pyetje që lidhin konceptet shkencore me koncepte të lëndëve apo fushave të tjera.
- ✓ Të kenë parasysh nivelin e diversitetit të nxënësve, duke përfshirë ushtrime që janë të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë, pavarësisht sfondit kulturor ose gjuhësor.
- ✓ Të respektojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të diturisë natyrës në testet kombëtare.
- ✓ Të hartojnë modele të testeve kombëtare në mënyrë që të punohen nga nxënësit gjatë viteve të shkollimit.

d) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.

- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve shkencore.
- ✓ Të vlerësojnë përfshirjen e qasjes STEM në planifikimin dhe zbatimin e mësimit të diturisë natyrës dhe të projekteve kurrikulare.
- ✓ Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të nxënësve.
- ✓ Të vlerësojnë organizimin e punës në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- ✓ Të vlerësojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të diturisë natyrës gjatë zhvillimit të orëve mësimore.
- ✓ Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënësve dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- ✓ Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socioemocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e diturisë natyrës.
- ✓ Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabël.

e) Rekomandime për prindërit

- Të inkurajojnë fëmijët që të kuptojnë rëndësinë e diturisë natyrës jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- Të bashkëpunojnë me shkollën për të ndihmuar fëmijët në pjesëmarrjen në projekte të lidhura me matematikën dhe qasjen STEM.
- Të promovojnë një qëndrim pozitiv ndaj mësimit të diturisë natyrës, duke theksuar rëndësinë e përpjekjes dhe të mësimit nga gabimet.
- Të sigurojnë që fëmijët ndihen të mbështetur emocionalisht dhe që mësimi i diturisë natyrës zhvillohet në një atmosferë të qetë dhe motivuese për fëmijët e tyre.

f) Rekomandime për nxënësit

- ✓ Të marrin pjesë aktive në orët e diturisë natyrës, duke kërkuar të kuptojnë përdorimin praktik të njohurive.
- ✓ Të angazhohen në projekte kurrikulare që lidhin matematikën me fusha të tjera përmes qasjes STEM.
- ✓ Të bashkëpunojnë me shokët dhe të mësojnë të zgjidhin probleme si në klasë ashtu edhe jashtë saj.
- ✓ Të jenë kureshtarë dhe të kërkojnë ndihmë kur hasin vështirësi, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe burimeve online.
- ✓ Të kuptojnë rëndësinë e diturisë natyrës si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.

10 Ndryshimet përmbajtësore

Programi për lëndën “Dituria e Natyrës” përfshin disa ndryshime të rëndësishme në përmbajtje, të cilat synojnë të përmirësojnë cilësinë e të nxënit dhe përputhshmërinë me zhvillimet bashkëkohore arsimore. Më poshtë paraqiten risitë kryesore:

- Programi strukturohet mbi Linjën kontekstuale “Shkenca në praktikë”, e cila fokusohet në mënyrën se si konceptet shkencore mund të prezantohen dhe eksplorojnë në mënyrë praktike përmes aktiviteteve praktike dhe tërheqëse dhe në përputhje me moshën.
- Shtohet tematika: “Të menduarit dhe të vepruarit në mënyrë shkencore” e cila synon të krijojë një bazë të fortë për zhvillimin e kuriozitetit në shkencë dhe aftësive fillestare të hetimit përmes lidhjes së shkencës me përvojat e përditshme të fëmijëve dhe eksplorimit praktik të botës që i rrethon.
- Janë riorganizuar linjat e përmbajtjes që rimerren në mënyrë të përsëritur gjatë gjithë cikleve:

Shtesa në rezultatet e të nxënit në tematikat e mëposhtme:

Elektriciteti dhe Magnetizmi:

- Identifikon objektet/pajisjet që punojnë me elektricitet.
- Shpjegon se çfarë ndodh kur magnetet afrohen dhe prekin trupa të përbërë nga materiale të ndryshme.

Toka dhe Hapësira:

- Shpjegon se planeti Tokë është i mbuluar kryesisht me ujë, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga shkëmbinj dhe dhera.
- Shpjegon se Toka është planeti në të cilin ne jetojmë.
- Përshkruan se Dielli është burim i nxehtësisë dhe dritës, si dhe një nga shumë yjet e hapësirës.

Vetitë e materialeve

- Përshkruan se si ndryshon materiali pas veprimit fizik (tërheqja, ngjeshja, përkulja, përdredhja etj.).

Rezultate të hequra:

Kuptimi për habitatin

- Eksploron mënyrat se si bimët dhe kafshët përshtaten për të jetuar në habitatet e tyre.
- Përshkruan si habitate të ndryshme plotësojnë nevojat jetësore të bimëve dhe kafshëve si dhe varësinë midis tyre.

Njerëzit dhe kafshët

- Tregon për nevojën e një diete të shëndetshme përfshirë edhe ushqimet e shëndetshme dhe ujin.

Rritja dhe ndryshimi:

- Vëzhgon dhe krahason ciklin e jetës të një bime me farë në një periudhë të caktuar kohe.
- Tregon se njerëzit dhe kafshët lindin pasardhës që kur rriten ngjajnë me prindërit e tyre.
- Vëzhgon ndryshimet që pësojnë gjatë ciklit të jetës kafshë si pula, bretkosa, flutura, kafshë shtëpiake dhe njeriu.
- Tregon kuriozitet duke bërë pyetje dhe eksploruar për ndryshimet gjatë rritjes tek bimët dhe kafshët në mjedisin përreth ose në modele.

Përditësime shtesë:

- Kompetencat kyçe dhe shkencore janë rishikuar dhe përmirësuar.
- Temat ndërkurrikulare janë integruar në mënyrë më të qartë.
- Metodologjia e mësimdhënies përfshin më shumë fokus te mendimi kritik, krijues, qasja STEM, të nxënit e personalizuar dhe socioemocional, si dhe përdorimi i teknologjisë.
- Vlerësimi është strukturuar sipas niveleve të arritjes, të lidhura me rezultatet e të nxënit.